

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-146/11**

**Prishtinë,  
31 maj 2012**

Në procedurën e:

**R.B.P.**

I përfaqësuar nga **M.M.M.**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/AR/101/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA47388), të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 31 maj 2012, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1- Pranohet ankesa e RP. si e bazuar.**

- 2- Ndryshohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/AR/101/2011, i datës 23 shkurt 2011, në pjesën e tij që ka të bëjë me kërkesën e paraqitur me 3 nëntor 2007 nga M.M. në emër të R.P., të regjistruar me numrin KPA47388.
- 3- Pranohen kërkesa e paraqitur me 30 nëntor 2007 nga M.M. në emër të R.P., e regjistruar me numrin KPA47388.
- 4- Konfirmohet e drejta pronësisë e R.P. të ngastrës kadastrale nr. 1368, që gjendet në vendin e quajtur “Pade-kodra”, zona kadastrale e Batllavës në Komunën e Podujevës, me sipërfaqe prej 0 ha 11 ari e 58 m<sup>2</sup>
- 5- I jepet posedimi i pronës së kërkuar R.P..
- 6- Çdo person që ka uzurpuar pronën duhet ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve na dorëzimi i këtij aktgjykimi; në rast të mosveprimit në pajtim me këtë urdhëresë brenda kohës së caktuar, personi do të dëbohet nga prona nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm.
- 7- Shpenzimet e procedurës do të mbulohen nga gjykata dhe paguhen nga burimet buxhetore.

**Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 30 nëntor 2007, M.M. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në emër të vjehrrit të tij, të shtrirë në spital dhe invalid, duke kërkuar konfirmimin e së drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës së tokës nr. 1368, që gjendet në vendin e quajtur “Pade-kodra”, zona kadastrale e Batllavës në Komunën e Podujevës, mal i klasës së 5-të me sipërfaqe prej 0 ha 11 ari 58 m<sup>2</sup> (e regjistruar në AKP si dosje e lëndës KPA47388, ndërsa e regjistruar në Gjykatën Supreme si GSK-KPA-A-146/11).

Ai ka pohuar se vjehrrit i tij ishte pronar i pronës së cekur dhe se e kishte humbur posedimin me 15 qershor 1999 dhe se ngastra ishte e uzurpuar nga një person i panjohur.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP aktvendimin N.nr. 51/73 i datës 26 shtator 1985 nga Gjykata Komunale e Podujevës duke cekur ndarjen e ngastrave të ndryshme dhe duke ia caktuar ngastrat e kontestuara kryesisht R.P.. Ai po ashtu ka paraqitur vendimin nr. 466-48/92 të Komunës së Podujevës, të datës 3 qershor 1993, me të cilën i është njohur R.P. dhe një personi tjetër edhe e drejta e kalimit në ngastrën e tyre nëpërmjet ngastre nr. 2495 që ndodhet në zonën kadastrale të Batllavës.

Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka vazhduar me njoftimin mbi kërkesën. Me 23 qershor 2008, ekipi për njoftimi i AKP-së ka vendosur një shenjë në ngastrën nr. 1368, duke cekur se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara është dashur t'i paraqisnin përgjigjen e tyre brenda 30 ditëve. Ngastra është gjetur e pauzuruar. Njoftimi është përsëritur me 23 prill 2010, dhe përsëri prona është gjetur e pauzuruar. Me 29 prill 2010, njoftimi është kontrolluar në bazë të koordinatave të GPS-it dhe ortofotografive dhe është gjetur të këtë qenë i saktë.

Raporti verifikues i AKP-së ka konstatuar vlefshmërinë e aktvendimit të Gjykatës Komunale të Podujevës. Sekretaria Ekzekutive ka përfshirë sipas detyrës zyrtare në dosje të lëndës fletën poseduese nr. 338 të zonës kadastrale të Batllavës, Komuna e Podujevës, e cila tregon se toka në fjalë ishte regjistruar në emër të R.P..

Disa herë ndërmjet korrikut 2008 dhe prillit 2009, Sekretaria Ekzekutive ka kërkuar pa sukses nga M.M. që të paraqes autorizimin që i është dhënë nga bartësi i së drejtës pronësore, R.P..

Me vendimin e saj KPKK/D/AR/101/2011 të datës 23 shkurt 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) ka hedhur poshtë kërkesën për arsye se M.M. nuk ishte anëtar i familjes së ngushtë siç definohet në nenin 1 të Urdhërësë Administrative të UNMIK-ut (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, dhe se ai nuk e kishte paraqitur në AKP autorizimin nga bartësi i së drejtës pronësore, ndonëse atij i janë dhënë mundësi të shumta për të bërë këtë.

Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar M.M. me 28 korrik 2011 dhe ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimi të lartpërmendur me datën 25 gusht 2011.

Në ankesën e tij, M.M. e ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së mbi bazë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të ligjit. Ai i ka paraqitur Gjykatës Supreme autorizimin e nënshkruar nga R.P. dhe të vërtetuar me 23 mars 2011 – VR. II nr. 20/2011 – nga Gjykata e Prokupljes në Serbi. Me autorizimin e tij, R.P. e ka autorizuar M.M. që t'i paraqes në AKP

kërkesat për pronën e uzurpuar dhe të shfrytëzojë mjetet juridike si dhe të ndërmarrë veprime faktike lidhur me lëndët të cilat janë regjistruar në AKP.

M.M.M. kërkon nga KKPK-ja që të anulojë vendimin e tij dhe t'ia njohë R.P. të drejtën e posedimit mbi ngastrën 1368.

### **Arsyetim ligjor:**

1. Kërkesa e M.M.M. duhet të interpretohet si ankesë me të cilën ai kërkon nga Gjykata Supreme që të prish vendimin e KKPK-së dhe të pranojë kërkesën

Vendimi i shkallës së parë i është dorëzuar përfaqësuesit të palës ankuese, Miladin Milivoje Milovanović, me 28 korrik 2011. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i vendimit. M.M.M. ka paraqitur ankesë e tij në emër të R.P. me kohë me 25 gusht 2011.

2. Gjykata Supreme konsideron se KKPK-ja i ka zbatuar drejt rregullat që kanë të bëjmë me përfaqësimin e palës. Megjithatë, ajo gjen se vendimi i kundërshtuar përfshin gabim esencial të dispozitave të së drejtës procedurale (Neni 182.1 i LPK-ës). Përfaqësuesi të paraqitësit të kërkesës nuk i është kërkuar formalisht që të korrigjojë dhe kompletojë kërkesën e tij. Për ta bërë këtë, një turrje telefonike nuk ka qenë e mjaftueshme, por është dashur që me anë të një kërkesë me shkrim atij t'i tërhiqet vërejtja për pasojat për mosveprim në përputhje me një kërkesë të tillë.

- a. Sa i përket përfaqësimit të palës, neni 5.2 i UA- së ndryshuar 2007/5 parasheh: *“Në procedurën para Komisionit, në rast se personi fizik nuk është në gjendje të bëjë kërkesë, kërkesa mund të bëhet nga anëtar i familjes së ngushtë të atij personi. Paraqitësi i kërkesës mund të përfaqësohet nga një person fizik i autorizuar me autorizim të vlefshëm dhe të zbatuar si dubet. Në raste të posaçme, ku dispozita e autorizimit është problematike, Sekretaria Ekzekutive mund të vërtetojë një dokument alternativ duke autorizuar përfaqësimin e paraqitësit të kërkesës.”*

Sipas nenit 1 të UA-së së njëjtë: *“Anëtar i familjes së ngushtë” d. m. th. bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët dhe personat e tjerë të cilët bartësi i të drejtës së pronës është i obliguar t'i mbajë në pajtueshmëri me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta mbajnë bartësin e së drejtës së pronës në pajtueshmëri me ligjin në fuqi, pa marrë parasysh nëse personi ka banuar apo*

*nuk ka banuar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës së pronës”.*

Në këtë rast, KKPK-ja ka vendosur drejtë se M.M. është dashur ta paraqes autorizimin. Bartësi i së drejtës pronësore, R.P., është nën kujdes mjekësor dhe i invalid. Një situatë e tillë është e mjaftueshme për të nxjerrë përfundimin se ai nuk është në gjendje të paraqes vetë kërkesë, prandaj ai mund të përfaqësohet. M.M. është dhëndëri i tij dhe, si i tillë, ai nuk është i obliguar ta mbajë vjehrrin e tij sipas ligjit mbi familjen në Kosovës nr. 2004/32. Prandaj, ai nuk është anëtar i familjes së ngushtë. Si rrjedhojë, me qëllim të përfaqësimit të R.P., ai duhet të paraqes një autorizimi të vlefshëm.

- b. Megjithatë, Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KKPK-së për të hedhur poshtë kërkesën për shkak të mosparaqitjes së autorizimit nuk është në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me mënyrën e kompletimit të kërkesës.

Neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 parasheh se dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative zbatohen përputhshmërisht në procedurën e Komisionit. Neni 39.1 i Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative parasheh: *“Në qoftë se kërkesa e palës së interesuar për fillimin e procedurës administrative nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e nenit 38 të këtij ligji, personi fizik dhe juridik që kërkon veprimin e organit administrativ, i kërkohet me shkrim korrigjimi i pasaktësive të kërkesës.”*

Në mesin e kresave të nenit 38 të këtij ligji, ekziston obligimi për të paraqitur kërkesën me shkrim, të nënshkruar dhe me datë të vendosur nga personi ose nga përfaqësuesi ligjor i personit.

Gjykata Supreme është e mendimit se fjalët *“kërkohet korrigjim”*, në kontekst së padisë së paraqitur në gjykatë, i referohen kërkesës formale duke përfshirë referimin rreth pasojave për mosveprim në përputhje me të ashtu siç bëhet zakonisht gjatë udhëzimit të lëndëve në të gjitha procedurat para gjykatave. Ky mendim gjithashtu mbështetet në detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë Ekzekutive ashtu siç përshkruhen në Aneksin II të UA-së të ndryshuar 2007/5, veçanërisht në nenet 1.1(a) dhe 4.1: Sekretaria Ekzekutive *“lehtëson mbledhjen e kërkesave”* dhe, në të njëjtën kohë zgjidhjen e kërkesave, *“të ndihmojë palët në zgjidhjen e kërkesave”*.

Me qëllim të interpretimit të dispozitave të UA-së, Gjykata Supreme, ashtu siç parashihet në nenin 13 të UA-së së njëjtë, “...mund të marrë parasysh, me modifikime apo kritere të tilla për të cilat konsideron se janë të nevojshme apo të dubura në rrethana të caktuara, dispozitat e ligjeve në fuqi mbi kompetencat e Gjykatës Supreme lidhur me procedurat civile duke përfshirë mutatis mutandis dispozitat e Urdhërësës Administrative Nr. 2003/13 të datës 11 qershor 2003 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”.

Neni 28.4 I Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6 mbi ndryshimin dhe zëvendësimin e UA-së së UNMIK-ut 2002/13 në lidhje me kriteret e pranushmërisë së kërkesës parashih se kur trupi gjykoës përcakton se nuk janë plotësuar kërkesat e pranushmërisë, nxjerrë një urdhëresë për paraqitësin e kërkesës në të cilën përcaktohet periudha e arsyeshme kohore për kompletimin dhe korigjimin e kërkesës, dhe urdhëresa cek se në çfarë mënyre kërkesa nuk i plotëson ato kërkesa dhe se urdhëresa të dorëzohet paraqitësit të kërkesës.

Sa i përket interpretimit, Gjykata Supreme konsideron se detyra e Sekretarisë Ekzekutive për “lehtësimin e mbledhjes së kërkesave” që domosdoshmërisht nënkupton mbledhjen e kërkesave të kompletuara e ngarkon atë me një rol aktiv dhe efikas në përgatitjen e kërkesave të kompletuara që do t’i përcillen Komisionit.

Gjykata Supreme vëren se, në rastet aktuale, dosjet tregojnë se M.M. është kontaktuar jo formalisht me 13 maj 2009 dhe me 13 gusht 2009 me telefon, ku atij i është kërkuar që të paraqes autorizimin të bartësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të familjes të bartësit të së drejtës pronësore. Atij i është dhënë një afat prej 30 ditëve. Së paku me 13 gusht ai gjithashtu është informuar se përndryshe kërkesa e tij do të hidhej poshtë.

Duke marrë parasysh pasojat e hedhjes poshtë të kërkesës për një procedurë e cila nuk mund të rifillohet më, për shkak se sipas nenit 8 të UA-së së ndryshuar 2007/5, periudha e pranimit të kërkesës skadon me 3 dhjetor 2007 për kërkesat para KKPK-së, Gjykata Supreme gjen se vetën një kërkesë me shkrim duke i cek pasojat për mospërbushjen e kërkesave në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, që i është dorëzuar palës, mund të shpie në hedhjen poshtë të kërkesës.

Në rastin në fjalë, një kërkesë e tillë formale nuk është bërë. Kështu që, përfaqësuesi i

paditësit nuk ka mundur të dijë me siguri të plotës se kërkesa mund të hidhet poshtë për shkak të mungesës së autorizimit. Kur ai e kuptoi ndikimin e kësaj mungese kur e ka pranuar vendimin e KKPK-së, ai e ka paraqitur me ankesën e tij kopjen e duhur, të vërtetuar dhe të vlefshme të autorizimit.

3. Si rredhë e arsytimit të dhënë me lartë, në pajtim me nenin 13.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Gjykata Supreme e pranon ankesë dhe merr një vendim të ri.

Me paraqitjen e autorizimit të vlefshëm, Gjykata Supreme konsideron se kërkesa është e kompletuar dhe në këtë mënyrë e pranueshme. Gjykata Supreme si rrjedhë e ka shqyrtuar kërkesën në bazë të meritave.

Në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, KKPK-ja dhe, në nivel të instancës së dytë, Gjykata Supreme ka kompetencë për të zgjidhur kërkesat në lidhje me konfliktet pronësore rreth pronës së paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën komerciale, që përfshijnë rrethanat që drejtëpërsëdrejti kanë të bëjnë ose ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, kur paraqitësi i kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tij pronësore.

Në rastin aktual, lëndë e kërkesës është pylli që përbënë pronën e paluajtshme bujqësore. Pala ankuese ka sqaruar se humbja e posedimit të ngastrave të cekura ka ndodhur me 15 qershor 1999, për shkak të situatës së përgjithshme të sigurisë dhe frikës së tij personale.

Këto elemente dhe koha e humbjes së posedimit sipas rrethanave të njohura mirë rreth sigurisë në Kosovë në qershor të vitit 1999 arsyetojnë që kërkesa të konsiderohet se bie në juridiksionin e Kolegjit të AKP-së të Gjykatës Supreme.

Me qëllim të dhënies së ri-posedimit, pala ankuese duhet të dëshmojë të drejtën e tij pronësore mbi ngastrën në fjalë. Për këtë qëllim, ai ka paraqitur aktvendimin N.nr.51/73 me datën 26 shtator 1985 nga Gjykata Komunale e Podujevës, duke cekur ndarjen e ngastrave të ndryshme dhe duke ia ndarë ngastrën e kontestuar kryesisht atij. Përveç kësaj, Sekretaria Ekzekutive ka paraqitur fletën poseduese nr. 338 të zonës kadastrale të Batllavës, Komuna e Podujevës, që tregon se ngastra në fjalë ishte regjistruar në emër të R.P..

Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80), “*e drejta pronësore mund të fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të akteve ligjore dhe me trashëgimi ...*”.

Vendimi i lartpërmendur i Gjykatës Komunale të Podujevës i referohet shprehimisht vendimit të plotfuqishëm mbi trashëgiminë T. Nr. 31/69 të lëshuar me 7 nëntor 1969 po ashtu nga Gjykata Komunale e Podujevës, i cila i ka shpallur bijtë e të ndjerit B.P. si trashëgimtarë të vetëm. Në mesin e tyre është edhe R.P.. Pastaj ka propozuar ndarje e pronës së paluajtshme dhe ia ka ndarë ngastrën në rastin në fjalë R.P.. Rezultati i këtij vendimi është regjistruar në operatin kadastral siç evidentohet nga lista posedues e paraqitur në procedurë.

Prandaj, Gjykata Supreme konkludon se këto dokumente përbëjnë dëshmi të së drejtës së paraqitësit të kërkesës dhe vjen në përfundim se pala ankuese e ka vërtetuar pronësinë mbi pronën e kërkuar. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme jep atij ri-posedimin e pronës në fjalë dhe urdhëron çdo person që në mënyrë të paligjshme ka uzurpuar pronë që ta lirojë atë brenda 30 ditëve të dorëzimit të këtij aktgjykimi. Mosveprimi në përputhje me këtë urdhër shpie në dëbimin nga prona.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë nenit 8.4 të Urdhëresës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit.

Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Gjykatës Supreme.

Pasi që pala ankuese fiton rastin dhe pasi që nuk ka palë përgjegjëse në ankesë, taksat gjyqësore mbulohen nga gjykatat.



### **Këshillë juridike**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**